



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 24717 prot.

Shkodër, më 02.12. 2025

VENDIM

Nr. 72, datë 27.11.2025

PLANI I LËVIZSHMËRISË SË QËNDRUESHME URBANE PËR SHKODRËN

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, referuar bashkëpunimit me ERI-ITA, Bankën Europiane të Investimeve (BEI), Fondin Shqiptar të Zhvillimit, mbështetur në nenin 54, shkronja "k", të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; ligjin nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", të ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar; ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit"; të ndryshuar; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; ligjin nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar; VKM nr. 1096, datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike"; si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë "Planin e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane në Bashkinë Shkodër", sipas materialit bashkëngjitur, pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 10

Zbardhur me datë 02.12.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



Adresa: Rr. "13 Dhjetori", Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al